



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione

Mbledhja nr. 02

Prishtinë, më 29. 03. 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Suzana Novoberdaliu – kryetare, Rita Hajzeraj - Beqaj, Biserka Kostiq, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi dhe Kymete Bajraktari.

Munguan: Justina. Sh. Pula, Duda Balje dhe Ismet Beqiri, që ishte në udhëtim zyrtar jashtë vendit.

E ftuar: Shqipe Krasniqi - ABGJ.

Pjesëmarrës të tjerë: Elita Vokshi – OSBE, Lejla Selimi - OSBE, Arben Kelmendi - NDI, Burim Tahiri, praktikant - Kuvendi i Kosoves.

Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Mbledhjen e drejtoi: Suzana Novoberdaliu - kryetare.

Suzana Novoberdaliu - Konstatoi se në bazë të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës ishin plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes dhe e propozoi këtë

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22. 03. 2011;
3. Takim me Shqipe Krasniqin nga Agjencia për Barazi Gjinore;
4. Shqyrtimi i peticioneve;
5. Të ndryshme.

Kryesuesja konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, mbajtur më 22. 03. 2011

Kryetarja - Konstatoi se Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes kaluar. 22.3. 2011.

3. Takim me Shqipe Krasniqin nga Agjencia për Barazi Gjinore

Kryetarja - Theksoi se për këtë pikë e kemi ftuar ushtruesen e kryeshefit të ABGJ-së, Shqipe Krasniqin, që në pika të shkurta t'i njoftojë anëtarët e Komisionin për nevojën eventuale për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për barazi gjinore dhe për pengesat e tij gjatë zbatimit. E falënderoi që iu ka përgjigjur ftesës dhe e ftoi ta merrte fjalën.

Shqipe Krasniqi – Në pika të shkurta e njoftoi Komisionin për punën e Agjencisë, si dhe për nevojën eventuale për plotësimin e Ligjit për barazi gjinore, që i promovon vlerat dhe mundësitë e barabarta, pa marrë parasysh përkatësinë gjinore. ABGJ-ja ka vërejtur se gjatë zbatimit të Ligjit në praktikë ka hasur shumë vështirësi, për shkak të vakumit legjislativ, që nuk janë identifikuar në kohën e hartimit.

Në mënyrë kronologjike ua paraqiti vërejtjet që kanë të bëjnë me fushën e Agjencisë, kurse lidhur me Ligjin prezantoi si vijon:

Neni 5.2(0) i Ligjit në të cilin theksohet: “Zyra për Barazi Gjinore, gjatë kryerjes se detyrave të theksuara në nenin 5.2 (a) deri te (n), i bashkërendoi aktivitetet me Zyrën Këshillëdhënëse për Qeverisje të Mirë, për të drejtat e njeriut, për mundësi të barabarta”. Ajo sugjeron që shtojca të hiqet nga Ligji. Arsyetimin për heqjen e shtojcës së Ligjit e bazoi në faktin se ka përzierje të kompetencave ndërmjet dy zyrave: Zyrës për Barazi Gjinore dhe Zyrës për Qeverisje të Mirë. Pastaj vijoi me nenet **4.12, 4.15, 4.17, 5.2 (1 dhe nenin 9)**.

Rita Hajzeraj – Beqaj – Anëtarët e Grupit Joformal të Grave i kanë vizituar institucionet në terren dhe kanë vërejtur se Ligji për barazi gjinore zbatohet vetëm në administratë edhe atë në kryerjen e punëve dytësore. Sa u përket pozitive menaxheriale e vendimmarrëse pozita e femrës nuk është e kënaqshme. Mendon se Komisioni duhet të ketë kontakte të vazhdueshme me Agjencinë për Barazi Gjinore, sepse si komision funksional u takon të merren me këtë punë, që të shihet sa respektohet Ligji për barazi gjinore dhe cilat pika nuk zbatohen.

Albana Gashi - Pyeti: *A ka plan pune Agjencia për Barazi Gjinore? Ku ka pasur ngecje në respektimin e barazisë gjinore? A keni pasur takime dhe raporte me shoqërinë civile?* Në bazë të këtyre pyetjeve mund të shihet çka është arritur dhe çka nuk është arritur me qëllim që të bëhen analizat.

Kymete Bajraktari - Kërkoi sqarim lidhur me nenin 6 të Ligjit për barazi gjinore, që ka të bëjë me avokatin për barazi gjinore, sepse s’kishte dijeni se ekzistonte ky avokat.

Shqipe Krasniqi – Iu përgjigj pyetjeve të shtruar, që u mirëpritën, nga të pranishmit.

Kryetarja - E falënderoi duke i çmuar lart vërejtjet. Për këtë arsye Komisioni do ta mbajë një tryezë të rrumbullakët, në të cilën do të ftohen ABGJ-ja, OJQ-të dhe shoqëria civile, me temën për vështirësitë, me të cilat po ballafaqohemi gjatë zbatimit në praktik të Ligjit për barazi gjinore. Në këtë drejtim kemi ofertë nga OSB-ja për mbështetje legislative.

4 . Shqyrtimi i peticioneve

Kryetarja – I njoftoi të pranishmit se i ka shqyrtuar dy peticione. Tha se peticioni i Sindikatës së Pensionistëve dhe i Invalidëve të Kosovës ishte temë e shqyrtimit në legjislaturën III. Komisioni pas një debati të frytshëm lidhur me peticionin e pensionistëve e nxori këtë

P ë r f u n d i m

Komisioni vendosi që gjatë shqyrtimit të këtij peticioni të ftohen të autorizuarit e peticionit që të informojnë për problemet e tyre.

Sa i përket peticionit të punëtorëve të HC “Emin Duraku”, tha se është shqyrtuar me kompetencë dhe me profesionalizëm dhe i është propozuar Komisionit ta nxjerrë këtë

P ë r f u n d i m

Komisioni konstatoi se kjo çështje nuk bie në fushëveprimin e tij, prandaj i rekomandon nënshkruesve të peticionit t’i drejtohen me kërkesë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

5. Ndryshme

Kryetarja - Tha se si Komisioni duhet të marrë vendim për emërimin e raportuesve që t’i raportojnë Komisionit. Duke u bazuar në Rregulloren e Kuvendit i propozoi Komisionit për nominimin e anëtarëve për fushat përkatëse dhe u nxor ky

V e n d i m

I. Formohet grupi raportuesve me këtë përbërje në këto fusha:

1. Personat e pagjetur: Kymete Bajraktari dhe Albana Gashi;
2. Peticionet: Rita Hajzeraj dhe Kurtan Kajtazi.

Për fushën e të drejtave të njeriut dhe barazi gjinore raportuesit do të emërohen në mbledhjen e radhës.

Në fund kërkoi nga anëtarët e Komisionit t’i përgatisin me kohë planet operative të punës.

Mbledhja përfundoi në orën 14: 00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzana Novoberdaliu